

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXII, nr. 6792  
E mërkurë, 28 dhjetor 2022  
çmimi 0.40 €

Sistemi ETIAS për  
udhëtim në zonën  
Shengen, zyrtarisht hyn në  
fuqi në nëntor 2023 **FAQE 7**



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

PËR 18 DITË ME RADHË RRUGËT QË ÇOJNË DREJT PIKAVE KUFITARE JARINJË DHE BËRNJAK, QË LIDHIN KOSOVËN ME SERBINË, JANË TË BLOKUARA NGA BARRIKADAT E VENDOSURA NGA SERBË LOKALË **FAQE 4-5**

## SERBËT VENDOSIN EDHE DY BARRIKADA TË REJA NË VERI



Në veri të Kosovës të martën janë vendosur edhe dy barrikada të reja me mjete të rënda. Njëra prej barrikadave është vendosur në udhëkryqin të shkollës teknike, ndërsa tjetra është vendosur te

vendi i quajtur Shkëmbi i Dudës. Ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, ka thënë se Serbia, e ndikuar nga Rusia, ka ngritur gjendje gatishmërie ushtarake dhe po urdhëron ngritjen e

barrikadave të reja, duke theksuar se janë në koordinim të ngushtë me partnerët ndërkombëtarë që kjo çështje të zgjidhet pa asnjë eskalim të mundshëm

### AKTUALE



REAGIM I KMDLNJ-SË / NË VERI SULMOHEN GAZETARËT, VENDOSEN BARRIKADA TË REJA, DERI KUR KËSHTU? **F.5**

NAGAVCI E RIZVANOLLI BISEDUAN ME NXËNËSIT E SHKOLLËS "FAIK KONICA" PËR KURSIMIN E ENERGISË ELEKTRIKE **F.7**

NË KLINIKËN E KARDIOLOGJISË REALIZOHET NUMËR REKORD I INTERVENIMEVE **F.6**

### EKONOMI



ALIU: ASFALTIMI I RRUGËVE NË VERI DO TA SHKURTOJË LËVIZJEN E TË GJITHË BANORËVE **F.8**

GËRVALLA NË EMIRATET E BASHKUARA ARABE DISKUTON PËR INVESTIMET NË KOSOVË **F.8**

### SPORT



PËRZGJIDHEN 10 'SHPRESAT OLIMPIKE 2023' QË MBËSHTETEN NGA MKRS-JA **F.12**

**HAXHIU:  
AMENDAMENTET  
KUSHTETUESE  
PËR VETINGUN,  
TË HARMONIZUARA  
ME REKOMANDIMET  
E VENECIAS** **FAQE 3**

**HARADINAJ: KFOR-i NUK  
ËSHTË PALË NË VERI, KURTI  
S'MUND T'I VENDOSË AFATE  
E AS KUSHTË,** **FAQE 3**

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepcisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...



## Zelensky u kërkon ukrainasve që të përgatiten për më shumë sulme ruse

KIEV, 27 DHJETOR - Presidenti i Ukrainës, Volodymyr Zelensky, tha mbrëmjen e 26 dhjetorit se ukrainasit duhet të përgatiten për më shumë sulme raketore ruse. Ai shtoi se mbrojtja ajrore e vendit dhe institucionet shtetërore po përgatiten për më shumë sulme. "Të gjithë duhet të përgatiten. Kushtoni vëmendje sirenavë, ju lutem!", tha ai. Duke folur për situatën në vijën e frontit, Zelensky tha se Bahmuti dhe Kremina janë zona që kërkojnë forcë dhe përqendrim maksimal. "Situata

atje është e vështirë, e dhimbshme. Pushtuesit po përdorin të gjitha burimet që kanë në dispozicion për të avancuar", tha ai.

Më 27 dhjetor Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura të Ukrainës tha se forcat ruse kanë nisur sulme të reja ndaj qyteteve në lindje të Ukrainës.

Rusia ka nisur pushtimin e Ukrainës më 24 shkurt dhe që nga tetori ka sulmuar vazhdimisht infrastrukturën e energjisë ukrainase.



## Tajvani zgjat shërbimin e detyrueshëm ushtarak për shkak të Kinës

TAJPEI, 27 DHJETOR - Tajvani njoftoi se do ta zgjasë shërbimin e detyrueshëm ushtarak nga katër muaj në një vit, duke u thirrur nga kërcënimet që po paraqet Kina, që sipas Tajvanit, është gjithnjë e më armiqësore.

Pekini e konsideron Tajvanin si pjesë të tij që ka thënë se do ta marrë një ditë, edhe me forcë nëse është e nevojshme. Ky ishull vetëqeverisës përballet me frikë të vazhdueshme nga një pushtim kinez.

Viteve të fundit, Kina, nën udhëheqjen e presidentit Xi Jinping ka intensifikuar kërcënimin ndaj Tajvanit. Po ashtu, pushtimi rus i Ukrainës ka thelluar më shumë shqetësimet në Tajvan se Kina mund të ndërmarrë lëvizje të ngjashme dhe të aneksojë ishullin. "Kërcënimet e Kinës kundër Tajvanit tani janë bërë më të qarta", tha presidentja e Tajvanit, Tsai Ing-wen, gjatë një konference për media pas takimit të Këshillit të Sigurisë Kombëtare. "Askush



nuk do luftë... por, bashkëkombës të mi, paqja nuk do të bie nga qielli", tha ajo, duke shtuar se shërbimi aktual ushtarak prej katër muajsh nuk është i mjaftueshëm, pasi po përballet me një situatë që po ndryshon

shpejt. "Ne kemi vendosur që ta rikthejmë shërbimin ushtarak prej një viti duke filluar nga viti 2024", ka thënë Tsai, duke theksuar se ky vendim do të aplikohet ndaj personave që kanë lindur pas 1 janarit të vitit 2005.

Shërbimi i detyrueshëm ushtarak dikur ishte shumë jopopullor në Tajvan, dhe qeveritë e kaluara vendosën që ky shërbim nga një vit të bëhej në katër muaj. Por, sondazhet e fundit tregojnë se mbi tre e katërta e të anketuarve

tani besojnë se katër muaj shërbim ushtarak janë pak.

Tsai tha se vendimi për kohëzgjatjen e shërbimit ushtarak ishte "vendim jashtëzakonisht i vështirë... për të siguruar mënyrë demokratike të jetës për generatat e ardhshme". "Ne mund të shmangim një luftë duke u përgatitur për një të tillë dhe ne mund të ndalim një luftë, vetëm nëse jemi të aftë të luftojmë", theksoi ajo.

Tajvani dhe Kina janë ndarë në fund të Luftës Civile Kineze të vitit 1949 dhe presidentja Tsai tha se bashkimi me Kinën nuk është opsion i pranueshëm nga banorët e ishullit.

Njoftimi për kohëzgjatjen e shërbimit ushtarak në Tajvan erdhi dy ditë pasi ushtria kineze kreu stërvitje ushtarake pranë këtij ishulli.

Pekini tha se stërvitjet ishin në përgjigje të "provokimeve" dhe "marrëveshjeve të fshehta" që sipas tij po bëjnë Tajpei dhe Uashingtonit.

## Netanyahu pranë krijimit të një prej qeverive më të djathta në historinë e Izraelit



JERUSALEM, 27 DHJETOR - Kryeministri i zgjedhur izraelit, Benjamin Netanyahu, bëri një hap para drejt krijimit të qeverisë së re, pas miratimit në parlament të një ligji që kishte shkaktuar shumë përçarje, por që në fund mori miratimin e partnerëve të tij në koalicion. Marrëveshja e arritur pas dy muaj negociatash, i mundëson Netanyahu krijimin e një prej qeverive më të djathta në historinë e vendit.

Ende pa marrë drejtimin e qeverisë së re, kryeministri i zgjedhur izraelit, Benjamin Netanyahu po përballet me kritika të ashpra mbi politikën e

tij.

Por ai është zotuar se do të qeverisë në të mirën e të gjithë izraelitëve, pavarësisht faktit se ai do të kryesojë një nga qeveritë më të djathta në historinë e vendit, me ministritë kryesore në duart e politikanëve të vijës së ashpër.

Pavarësisht fitores bindëse në zgjedhjet e nëntorit të bllokut të tij të përbërë nga parti të djathta e me qasje fetare, Netanyahu i janë dashur pothuajse dy muaj për arritjen e një marrëveshjeje me aleatët e tij, të cilët kërkuar një pjesë të konsiderueshme të pushtetit në këmbim të mbështetjes së tyre.

Miratimi të martën i amendamenteve që hapin rrugën drejt krijimit të qeverisë së re, i mundëson partisë nacionaliste të Zionizmit Fetar marrjen e postit të ministrit të mbrojtjes, gjë që i jep asaj autoritetet të gjerë në zgjerimin e vendbanimeve hebraike në Bregun e pushtuar Perëndimor, toka ku palestinezët kërkojnë shtetin e tyre.

Amendamenti i dytë i mundëson Aryeh Deri-t, kreut të partisë ultra-ortodokse Shas të shërbejë si ministër, pavarësisht faktit se ai është dënuar për mashtrim me taksat.



## Haradinaj: KFOR-i nuk është palë në veri, Kurti s'mund t'i vendosë afate e as kushte

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 27 DHJETOR - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), Ramush Haradinaj, duke folur për barrikatat e vendosura në veri, ka thënë se KFOR-i nuk është palë dhe nuk mund të konsiderohet si i tillë. Në një konferencë për medie, ai i ka bërë thirrje kryeministrit të vendit, Albin Kurti, që të heqë

dorë nga, siç ka thënë, retorika e tij kundërshtuese dhe kushtëzuese ndaj KFOR-it. Sipas tij, veprimet dhe deklarimet e pamatura të kryeministrit dhe të vartësve të tij po e rëndojnë situatën në pjesën veriore të vendit. "Kurti e njerëzit e tij nuk janë duke vepruar drejt. Veprimet dhe deklarimet e pamatura të tyre janë duke e rënduar situatën. KFOR-i nuk është palë dhe nuk mund të konsiderohet si i tillë, ndaj nuk

mund t'i vendosen afate kohore e as kushte. Misioni i tij është i qartë dhe i pastër si loti. Palë në Kosovë nuk janë as Uashingtoni e as Brukseli. Ata janë aleatë të paqes e të sigurisë në Kosovë", ka deklaruar Haradinaj, duke shtuar se kryeministri duhet të heqë dorë nga retorika kundërshtuese e kushtëzuese ndaj tyre. "E ardhmja e Kosovës është e lidhur përjetësisht me aleatët ndërkombëtarë, posaçërisht me Amerikën. I bëj thirrje

kryeministrit që të mos përdorë praktikë vepruese ndaj KFOR-it sikur ajo të jetë palë", është shprehur para gazetarëve Haradinaj të martën. Ai ka thënë se situata në veri të Kosovës po bëhet gjithnjë e më serioze. "Platforma luftënxitëse e Vuçiqit dhe njerëzve të tij të instaluar në veri po i kalon vijat e kuqe. Ai duhet urgjentisht ta urdhërojë heqjen e barrikadave e t'i kthehet tryezës së dialogut. Ai nuk mund ta sfidojë Kosovën e

përcaktuar për paqe", është shprehur Haradinaj. I pari i AAK-së ka pasur një kërkesë edhe për serbët e Kosovës. "Mos të bien pre e kalkulimeve politike të askujt e as të Vuçiqit. E ardhmja e tyre është në Kosovë, në paqe e harmoni me të gjithë të tjerët. Andaj, largohuni nga barrikatat. Barrikatat sot janë vetëm interes i Putinit, por jo edhe i serbëve dhe shqiptarëve", ka thënë Haradinaj.



## Haxhiu: Amendamentet kushtetuese për vetingun, të harmonizuara me rekomandimet e Venecias



Prishtinë, 27 dhjetor - Ministria e Drejtësisë, Albulena Haxhiu, ka raportuar të martën para Komisionit Ad-hoc për zhvillimin e procesit të vetingut, ku ka prezantuar pakon e vetingut. Ajo ka bërë me dije se anëtarët e Komisionit i ka njoftuar me rrjedhën e procesit që nga prilli i vitit 2021 dhe ka theksuar se amendamentet kushtetuese për vetingun janë të harmonizuara

me rekomandimet e Venecias dhe janë të gatshme për procedim në Gjykatën Kushtetuese. "Duke qenë një nga proceset më të rëndësishme, në këtë takim shpreha edhe vullnetin e Ministrisë së Drejtësisë për ta ndihmuar Komisionin për përmbylljen e kësaj reforme me peshë të madhe për vendin dhe qytetarët", ka thënë ministria Haxhiu.

Pas prezantimit të Haxhiut, çështjet që ngritën interes dhe u diskutuan mes ministres dhe anëtarëve të Komisionit Ad-hoc, ndër të tjera, përfshinë vlerësimin e draft-amendamenteve kushtetuese nga Komisioni i Venecias, përmbajtjen e ligjeve që do të pasojë pas amendamenteve kushtetuese dhe bashkëpunimin juridik ndërkombëtar gjatë zhvillimit të procesit të vetingut.

## Aktakuzë kundër 11 personave për veprat penale kundër krimit të organizuar

Prishtinë, 27 dhjetor - Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës (PSRK) ka ngritur aktakuzë në

Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamentin Special, kundër njëmbëdhjetë të pandehurve për vepra

penale që ndërlidhen me krimin e organizuar. Ky rast ishte i përzgjedhur si rast i shënjestruar për shënjestrimin

e krimeve të rënda si pjesë e përpjekjes për të prezantuar rezultate konkrete në fushën e mbizotërimit të ligjit.







PËR 18 DITË ME RADHË RRUGËT QË ÇOJNË DREJT PIKAVE KUFITARE JARINJË DHE BËRNJAK, QË LIDHIN KOSOVËN ME SERBINË, JANË TË BLOKUARA NGA BARRIKADAT E VENDOSURA NGA SERBË LOKALË

# Serbët vendosin edhe dy barrikada të reja në veri

Në veri të Kosovës të martën janë vendosur edhe dy barrikada të reja me mjete të rënda. Njëra prej barrikadave është vendosur në udhëkryqin të shkolla teknike, ndërsa tjetra është vendosur te vendi i quajtur Shkëmbi i Dudës. Ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, ka thënë se Serbia, e ndikuar nga Rusia, ka ngritur gjendje gatishmërie ushtarake dhe po urdhëron ngritjen e barrikadave të reja, duke theksuar se janë në koordinim të ngushtë me partnerët ndërkombëtarë që kjo çështje të zgjidhet pa asnjë eskalim të mundshëm

**EPOKA E RE**

**Mal QORRAJ**

Prishtinë, 27 dhjetor - Në veri të Kosovës më 27 dhjetor janë ngritur dy barrikada të reja. Një barrikadë është vendosur në Mitrovicë të Veriut, afër Lagjes së Boshnjakëve, ndërsa barrikada tjetër është vendosur te vendi i njohur si Shkëmbi i Dudës, në komunën e Zveçanit. "Në veri të vendit gjatë natës persona/grupe kriminale kanë vazhduar vendosjen e barrikadave duke penguar edhe më tej lirinë e lëvizjes së lirë. Referuar informacioneve zyrtare, janë vendosur edhe dy barrikada me mjete të rënda. Njëra prej barrikadave është vendosur në udhëkryqin të shkolla teknike, tjetra është vendosur te vendi i quajtur Shkëmbi i Dudës. Ministri i Punëve të Brendshme, Xhelal Sveçla, ka thënë se Republika e Kosovës nuk ka qasje agresore e me aspirata pushtuese si Serbia. Ai ka thënë se Serbia, e ndikuar nga Rusia, ka ngritur gjendje gatishmërie ushtarake dhe po urdhëron

ngritjen e barrikadave të reja. "Republika e Kosovës ka synim paqen e stabilitetin, ndërsa Serbia e ka destabilizimin dhe luftën. Deklarimet se Republika e Kosovës ka ngritur gjendje gatishmërie janë tërësisht të pavërteta dhe janë pjesë e propagandës së dyshes Serbi - Rusi. Është pikërisht Serbia e ndikuar nga Rusia ajo që ka ngritur gjendje gatishmërie ushtarake, po urdhëron ngritjen e barrikadave të reja, për t'i arsyetuar dhe mbrojtur grupet kriminale që terrorizojnë në veçanti qytetarët e etnisë serbe që jetojnë në Kosovë", ka shkruar Sveçla në "Facebook".

Ai ka thënë se nuk janë të interesuar për luftë, por angazhohen për luftim të kimit dhe terrorizmit brenda shtetit tonë. "Kjo i pengon Serbisë sepe ndër vite ka mirëmbajtur në të gjitha format grupet kriminale në veri të vendit. Policia e Kosovës është duke zbatuar si kudo në Republikën e Kosovës mandatin e saj ligjor. Ka detyra të përditshme të tyre e jo gatishmëri për luftë. Kjo vlen

edhe për Forcën e Sigurisë së Kosovës e cila kryen detyrat e saj të përditshme dhe as që bëhet fjalë për ngritje të gatishmërisë apo angazhim të rezervistëve", ka shkruar Sveçla.

Ministri Sveçla ka thënë se institucionet e Republikës së Kosovës janë në koordinim të ngushtë me partnerët ndërkombëtarë që kjo çështje të zgjidhet pa asnjë eskalim të mundshëm. "Ky fakt dukshëm po i pengon Serbisë e cila po angazhohet maksimalisht që barrikadat të prodhojnë qoftë edhe viktima në njerëz dhe kjo dëshmohet nga sulmet e njëpasnjëshme të armatosura ndaj zyrtarëve policorë, pjesëtarëve të EULEX-it e, së fundmi, edhe ndaj KFOR-it. Me barrikadat si mjet, Serbia po lufton sovranitetin dhe integritetin territorial të shtetit fqinj, Kosovës, ndërkaq ne jemi të interesuar të luftojmë krimin dhe bandat kriminale, brenda shtetit tonë, të kujtdo qofshin ato", ka thënë ai, duke shtuar se kurdo që lufta kundër kimit po shpërfaq që ushtrimi legjitim i

kompetencave në vendin tonë është në dobi të secilit qytetar pavarësisht etnisë, Serbia në krye me Vuçiqin po tenton me çdo kusht t'i cenojë vlerat demokratike që shteti ynë ka promovuar dhe do të vazhdojë të mbrojë. "Andaj, ne nuk do të ndalemi drejt mbrojtjes së këtyre vlerave demokratike dhe të qenit pranë të gjithë qytetarëve tanë pa dallim pavarësisht prej tendencave kërcënuese", ka shkruar Sveçla.

Grupe qytetarësh serbë qysh më 10 dhjetor kanë ngritur mbi dhjetë barrikada në veri të Kosovës, përkatësisht në rrugët që çojnë kah vendkalimet kufitare me Serbinë, Jarinjë dhe Bërnjak. Dy të fundit janë vendosur më 27 dhjetor në Mitrovicë të Veriut. Barrikadat janë vendosur në shenjë proteste ndaj arrestimit të ish-pjesëtarit serb të Policisë së Kosovës, Dejan Pantiq.

Qëkur janë ngritur barrikadat në veri të Kosovës janë shënuar një numër incidentesh me armë zjarri, granata dore dhe shok bomba.

Cak i sulmeve kanë qenë pjesëtarët e Policisë së Kosovës, të misionit të Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit (EULEX), patrulla të KFOR-it dhe gazetarët.

Më 25 dhjetor KFOR-i ka njoftuar se ndodhën të shtëna pranë një patrulle të misionit në Zubin

Potok.

Misioni i NATO-s në Kosovë ka nisur hetimet për këtë incident. Ndërkaq, Policia e Kosovës ka shtuar praninë e saj në veri të Kosovës, duke thënë se synon të garantojë siguri për të gjithë qytetarët.

Autoritetet në Kosovë kanë thënë se "bandat kriminale që mbështeten nga Serbia" qëndrojnë pas barrikadave. Qeveria e Kosovës ka thënë se shteti ka kapacitete t'i heqë barrikadat, por i ka dhënë kohë misionit të NATO-s në Kosovë, KFOR, që t'i heqë barrikadat. Presidenti serb, i cili është edhe komandant i përgjithshëm i Forcave të Armatosura të Serbisë, Aleksandar Vuçiq, ka urdhëruar që ushtria dhe të gjitha njësitë Ministrisë së Punëve të Brendshme të jenë në nivelin më të lartë të gatishmërisë luftarake.

Ministri serb i Mbrojtjes, Millosh Vuçeviq, tha mbrëmjen e 26 dhjetorit se Vuçiqi ka urdhëruar që "Forcat e Armatosura të Serbisë të jenë në nivelin më të lartë të gatishmërisë luftarake, gjegjësisht gatishmërisë deri në nivelin e përdorimit të forcës së armatosur".

Ai tha se rritja në nivelin më të lartë të veprimit nga ushtria serbe bëhet për ta "mbrojtur integritetin territorial dhe sovranitetin e Serbisë dhe për t'i mbrojtur të gjithë qytetarët e



REAGIM I KMDLNJ-së

# Në veri sulmohen gazetarët, vendosen barrikada të reja, deri kur kështu?

Sipas Q. R. të KMDLNJ-së në Mitrovicë, ekipi i Klan Kosovës për herë të dytë është sulmuar nga persona të maskuar duke penguar gazetarët në përmbushjen e mandatit të tyre, informimin e publikut në mënyrë të pavarur, profesionale dhe të drejtë për zhvillimet në Veri të Kosovës e që paraqet interes për publikun ku mungesa e ligjit i ka zënë vend zbatimit të ligjit dhe ku shkelet njëra ndër të drejtat themelore të njeriut, e drejta për liri të lëvizjes. Sulmi i fundit ndaj ekipit të Klan Kosovës u bë Zupç të Zubin Potokut me gurë u sulmua vetura ku ishin gazetarët Qëndresa Bellagoshi dhe Drin Demiri, kameramani Agon Bejtullahu dhe vozitësi Elsad Sinani me ç'rast u lënduan gazetari dhe vozitësi i Klan Kosovës. Personat e maskuar, pas sulmit u tërhoqën në barrikadën e vendosur. Ky sulm dhe sulmet tjera kanë për qëllim

krijimin e një terri informativ në këtë pjesë të Kosovës në mënyrë që më lehtë të shpërndahen lajmet e rreme nga Beogradi dhe qarqet ekstremiste të njëjësive paramilitare në Veri të Kosovës. KMDLNJ i konsideron këto sulme si shkelje të rënda të drejtave të njeriut, rrezikim të jetës së gazetarëve të cilët, ndonëse identifikohen lehtë si gazetarë, nuk mbrohen nga askush gjatë përmbushjes së mandatit të tyre, EULEX-i dhe KFOR-i në radhë të parë, si institucione garantuese të sigurisë për faktin se Policia e Kosovës është e penguar ta kryejë mandatin që i takon sipas ligjit. Po në të njëjtën kohë janë vendosur edhe dy barrikada duke e rritur numrin në 11-të që paraqet pengesa shtesë për lirinë e lëvizjes për të gjithë qytetarët, pavarësisht përkatësive etnike, moshës, gjinisë, bindjeve fetare etj. Vendosja e barrikadave, në sy të

ndërkombëtarëve është inkurajim për forcat ekstremiste dhe njësitë paramilitare, të armatosura dhe të maskuara dhe legalizim i shkeljeve flagrante të të drejtave të njeriut, nga e drejta për jetë si e drejta kryesore, te pamundësia e lirisë së lëvizjes, qasjes në shërbime publike, shkollim, shëndetësi dhe të tjera që e krijojnë një rreth të mbyllur për liri të lëvizjes, të ndara në baza etnike. Institucionet e Kosovës, përveç deklarimeve publike nga ambiente të sigurta nuk janë në gjendje, për shkaqe objektive dhe subjektive të ndërmarrin asnjë veprim që do t'i eliminonte këto barrikada fizike, si kusht i domosdoshëm për një marrëveshje politike që do ta rikthente qoftë edhe pjesërisht normalitetin në atë pjesë të Kosovës, e kontrolluar nga Serbia dhe bashkësia ndërkombëtare! Rritja e numrit të barrikadave kanë prapavijë ekskluzivisht politike,

nuk kanë të bëjnë fare me shkelje të drejtave të njeriut ndaj serbëve dhe heqja e tyre po kushtëzohet dhe do të kushtëzohet me kërkesa politike. Në njërin anë e forcon pozitën negociuese të Serbisë kurse, në anën tjetër e dobëson pozitën e Kosovës. KMDLNJ fiton të gjitha subjektet politike në Kosovë, pozitë dhe opozitë të ndërtojnë një konsensus shtetëror, politik dhe kombëtar në mënyrë që të tejkalohet kjo situatë dhe të mos shpenzojnë energji duke e luftuar njëra-tjetrën për faktin se problemi i madh dhe objektiv është me Serbinë. Nuk duhet të lejohet që anarkia institucionale të bartet në pjesët e tjera të Kosovës. KMDLNJ nuk sheh se në Veri të Kosovës mund të përshkallëzohet situata në përmasa që nuk mund të mbahet nën kontroll dhe përkujton institucionet e Kosovës se kanë përgjegjësi ligjore dhe

kushtetuese të krijojnë dhe garantojnë siguri për të gjithë qytetarët e Kosovës, pa bërë asnjë dallim dhe, në të njëjtën kohë kërkon që të rezervohen nga deklaratat që do të kontribuojnë në tensionimin e situatës e që, në jo pak raste janë të papërgjegjshme dhe në kundërshtim me mundësitë për të vepruar. Policia e Kosovës nuk duhet të lejojë që në një vend ku e kanë shumë të qartë mandatin dhe detyrimin ligjor të lejojnë të barten me helikopter të EULEX-it, si akt mëshire. Policia e Kosovës duhet t'i lirojë linjat qarkullimit, komunikimit dhe të furnizimit, gjithnjë në përputhje me ligjin, si për vete ashtu edhe për të gjithë qytetarët e Veriut të Kosovës, pa bërë asnjë diskriminim. Sa më shumë që të zgjatet koha e barrikadimit dhe barrikadat, situata vetëm sa do të përkeqësohet.



Serbisë, duke parandaluar terrorizmin dhe terrorin ndaj serbëve kudo që jetojnë". "Nuk ka arsye për panik, por ka arsye për shqetësim, sepse duket se Serbia është e vetmja palë e interesuar për të biseduar, për marrëveshje politike, për t'u takuar qoftë edhe një mijë herë derisa të gjendet ndonjë marrëveshje. Pala tjetër është duke bërë vazhdimisht lëvizje të njëanshme, ngritur tensione dhe vazhdimisht çon në përshkallëzim të mëtejshëm të situatës që, për mendimin tim, ka një synim të qartë për pastrim të plotë etnik të Kosovës dhe Metohisë", ka theksuar Vuçeviq.

## Protestë para Ambasadës së Serbisë në Tiranë për shkak të situatës në veri të Kosovës

Disa qytetarë protestuan të martën para Ambasadës së Serbisë në Tiranë të Shqipërisë. Të nxitur nga situata në veri të Kosovës, qytetarët u mbledhën para Ambasadës së Serbisë duke kërkuar zgjidhje për këtë situatë.

Me veshje kombëtare të trevave të ndryshme shqiptare, me flamuj të Shqipërisë, Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara, protestuesit brohoritën slogane sikurse "Hiqni duart nga Kosova, Mitrovica është e jona".





## Ish-deputeti Frashër Krasniqi dhe të tjerët lirohen nga akuza për terrorizëm

PRISHTINË, 27 DHJETOR - Gjykata Themelore në Prishtinë ka shpallur aktgjykimin lirues ndaj të akuzuarve Frashër Krasniqi, Adea Batusha, Egzon Haliti dhe Atdhe Arifi, lidhur me akuzën për terrorizëm.

Aktgjykimi ndaj të akuzuarve u shpall të martën nga kryetari i trupit gjykues Vesel Ismaili, raporton "Betimi për Drejtësi". Në këtë proces gjyqësor, i cili ishte kthyer në rigjykim, Krasniqi, Batusha, Haliti dhe Arifi akuzoheshin se janë përgjegjës për sulmin në Kuvendin e Kosovës në gushtin e vitit 2016, që është kualifikuar

si vepër terroriste.

Sipas aktgjykimit, Frashër Krasniqi, Adea Batusha, Egzon Haliti dhe Atdhe Arifi lirohen nga aktakuza, pasi nuk është vërtetuar se të njëjtët kanë kryer veprën penale që u vihej në barrë.

Shpenzimet procedurale bien në barrë të gjykatës.

Më tutje, gjykatësi Ismaili ka treguar në pika të shkurtra ecurinë e rastit, duke thënë se lidhur me këtë rast ky trup gjykues në rigjykim ka mbajtur 13 seanca, janë dëgjuar më shumë se 11 dëshmitarë, janë administruar provat materiale,

të cilat janë propozuar nga Prokuroria Speciale dhe shtoi se as pas dëgjimit të deklaratave të dëshmitarëve nuk është arritur të provohet fajësia e të akuzuarve.

Këtë rast fillimisht e kishte gjykuar gjykatësi Beqir Kalludra por, pas avancimit të tij në Gjykatën e Apelit, me vendimin e 21 dhjetorit 2020, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK), lënda ka kaluar te gjykatësi Kushtrim Shyti, më pas përfundimisht këtë lëndë e gjykoi gjykatësi i Departamentit Special, Vesel Ismaili.



Pas rigjykimit, para trupit gjykues të udhëhequr nga gjykatësi Kalludra, ishin

caktuar gjithsej gjashtë seanca, prej të cilave vetëm tri kishin arritur të mbahen.

## Në Klinikën e Kardiologjisë realizohet numër rekord i intervenimeve



**EPOKA ERE**

FATON DËRMAKU

PRISHTINË, 27 DHJETOR - Në Laboratorin e Elektrostimulimit dhe Elektrofiziologjisë së zemrës në Klinikën e Kardiologjisë të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës është realizuar numër rekord i intervenimeve. Në javën që lamë pas stafi i Klinikës së Kardiologjisë ka kryer shtatë intervenime elektrofiziologjike me ablacion dhe gjashtë implantime të pajisjeve komplekse CRT-D, duke shënuar rekord të ri.

U realizuan procedurat e studimit elektrofiziologjik me ablacion të suksesshëm (djegie të vatrës aritmogjene), me metodën e navigacionit elektroanatomik (3-D Mapping) te shtatë pacientët e moshave prej 20-56 vjeç.

Janë implantuar gjashtë pajisje të resinkronizimit elektrik të zemrës me defibrilator (CRT-D) te pacientët me dëmtim kronik të muskullit të zemrës, te të cilët terapia medikamentoze ka qenë e pamjaftueshme për t'u siguruar kualitet minimal jetëse e për më tepër për t'i mbrojtur nga aritmitë jetë kërcënuese.

Laboratori i Elektrostimulimit dhe Elektrofiziologjisë është një nga shërbimet e Klinikës së Kardiologjisë i cili është i vetmi në

nivel vendi i specializuar për trajtimin e çrregullimeve të ritmit dhe përcimit të zemrës me metoda intervenive.

Ky laborator tashmë me traditë të gjatë ka filluar punën në vitet '80 dhe është avancuar gradualisht, ndërsa në vitin e fundit ka zgjeruar gamën e intervenimeve, duke u kryer për herë parë me sukses procedura komplekse dhe bashkëkohore të tilla si studimi elektrofiziologjik i zemrës me ablacion radiofrekuent (djegien e vatrës aritmogjene).

Njëkohësisht ka vazhduar edhe implantimi i pajisjeve elektrike të implantueshme në zemër, duke filluar nga pacemakerët e thjeshtë e deri te pajisjet më komplekse si defibrilatorët intrakardiakë (ICD) dhe pajisjet për resinkronizimi elektrik të zemrës (CRT). E gjithë kjo falë angazhimit dhe përkushtimit maksimal të stafit të profesionalizuar të këtij shërbimi dhe bashkëpunimit tashmë të vazhdueshëm me ekspertë ndërkombëtarë të cilët asistojnë në këto procedura dhe bëjnë trajnimin e stafit tonë nëpër qendrat e specializuara prej nga ata vijnë.

Këto rekorde numrash, metodologjia dhe teknikat që po përdoren, janë krejtësisht të reja dhe të krahasueshme me qendrat e avancuara evropiane.

## AKK-ja vazhdon projektin edhe për tri vjet me NALAS dhe GIZ

PRISHTINË, 27 DHJETOR - Është arritur marrëveshja në mes të Asociacionit të Komunave të Kosovës, NALAS-it dhe Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH i financuar nga Ministria Federale për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik e Republikës së Gjermanisë për vazhdimin e Projektit "Të Drejtat sociale për Grupet e Pafavorizuara III (SoRiIII) dhe për tre vitet e ardhshme".

Projekti "Të drejtat sociale për Grupet e Pafavorizuara III" do ta promovojë përfshirjen sociale dhe ekonomike përmes

institucionalizimit të gjërave më të mira, inovative dhe shërbimet sociale të orientuara nga nevojat. Projekti rajonal të Drejtat Sociale për Grupet e Pafavorizuara (SoRi III) aktualisht është duke u zhvilluar si vazhdim masë e projektit SoRi II të përkrahur nga Ministria Federale për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillimin (BMZ) e Gjermanisë. Ky projekt do të ofrojë një përmbledhje të shkurtër të disa prej aspekteve kryesore të planifikuara deri më tani.

Në këtë projekt rajonal bëjnë pjesë Kosova, Shqipëria, Bosnja-Hercegovina, Maqedonia e Veriut

dhe Serbia, ndërsa koordinohet përmes Rrjetit të Asociacioneve të Autoriteteve Lokale të Evropës Juglindore (NALAS) brenda periudhës janar 2023 - maj 2025 dhe me një buxhet prej katër milionë eurosh.

Fushat tematike të planifikuara të projektit janë: Koordinimi në shumë nivele dhe forcimi i kornizës së politikave për përfshirjen sociale; Forcimi i qasjeve sociale të orientuara nga nevojat, të bazuara në dëshmi dhe inovative; dhe Forcimi i modeleve multisektoriale për përfshirjen ekonomike të grupeve të pafavorizuara.





## Sistemi ETIAS për udhëtim në zonën Shengen, zyrtarisht hyn në fuqi në nëntor 2023

PRISHTINË, 27 DHJETOR - Përveç qytetarëve të Kosovës, të gjithë të tjerët nga shtetet e Ballkanit mund të udhëtojnë në zonën evropiane të Shengenit pa vizë apo ndonjë miratim paraprak, por nga viti 2023 kjo nuk do të jetë më e mundur pa dorëzuar një kërkesë online përmes Sistemit Evropian të Autorizimit të Udhëtimit (ETIAS).

Sipas planeve të para, ETIAS ishte menduar të vihej në funksion tashmë në janar, më pas u shty deri në maj 2023, por tani pritet që zbatimi i atij sistemi të nisë në nëntor të vitit të ardhshëm, gjë që u njoftua edhe në faqen zyrtare të Bashkimit Evropian.

Formulari i aplikimit online do të dorëzohet në faqen zyrtare të internetit të ETIAS ose aplikacionin celular, i cili do të lansohet kur ETIAS të bëhet funksional. Aplikimi duhet të plotësohet jo më vonë se 96 orë para datës së udhëtimit dhe duhet të përfshijë një email adresë, më pas të dhënat e pasaportës, si dhe të dhënat personale.

Hapi i fundit është ta paguani tarifën e aplikimit nëpërmjet kartës së kreditit ose debitit. Tarifa e aplikimit do të jetë shtatë euro për të gjithë aplikantët që janë më të vjetër se 18 dhe më të rinj se 70.



Me rastin e paraqitjes së aplikacionit paguhet një tarifë prej shtatë eurosh dhe kjo është e vetmja tarifë që duhet paguar. Të miturit dhe personat mbi 70 vjeç do të marrin ETIAS falas.

Vlerësohet se procesi i aplikimit do të zgjasë rreth dhjetë minuta dhe miratimi duhet të merret brenda pak minutash nga

momenti i dorëzimit të aplikimit. Miratimi i marrë do të jetë i vlefshëm për tre vjet dhe gjatë kësaj periudhe numri i udhëtimeve në vendet e BE-së nuk është i kufizuar. Me ETIAS, qytetarët e vendeve jashtë BE-së do të mund të qëndrojnë në Bashkimin Evropian për maksimum 90 ditë në një

periudhë prej 180-ditësh.

Por nga nëntori 2023 këta qytetarë do të duhet të kenë një ETIAS për të hyrë në 30 vendet e mëposhtme: Austri, Belgjikë, Bullgari, Kroaci, Qipro, Republika Çeke, Danimarkë, Estoni, Finlandë, Francë, Gjermani, Greqi, Hungari, Islandë, Itali, Letonia, Lihtenshtajni, Lituania,

Luksemburgu, Malta, Holanda, Norvegjia, Polonia, Portugalia, Rumania, Sllovakia, Sllovenia, Spanja, Suedia dhe Zvicra. Prandaj, qytetarët e Serbisë do të kenë nevojë për ETIAS për të vizituar mikro-shtetet evropiane me kufij të hapur: Monako (nëpërmjet Francës), San Marino (nëpërmjet Italisë) dhe Vatikani (nëpërmjet Italisë).

Një praktikë e ngjashme ekziston tashmë në ShBA, Kanada dhe Australi, ndërkohë që vetë ideja e futjes së autorizimit ETIAS daton në vitin 2016. Sistemi duhet të kontribuojë në zvogëlimin e rreziqeve aktuale të sigurisë, shëndetit dhe migracionit dhe zbatohet për 63 vende që nuk janë anëtare të Bashkimit Evropian, por qytetarët e të cilëve mund të udhëtojnë pa viza në zonën Shengen.

Ajo që për qytetarët e Kosovës është i rëndësishëm, futja në aplikim i këtij sistemi, është fakti se liberalizimi i vizave për Kosovën lidhet pikërisht me këtë sistem, respektivisht nëse aplikimi i tij fillon në nëntor, atëherë edhe banorët e Kosovës mund të udhëtojnë pa viza në BE. Por nëse ky sistem ndodh të shtyhet, atëherë lëvizja pa viza për kosovarët hyn në fuqi automatikisht nga 1 janari i vitit

## Nagavci e Rizvanolli biseduan me nxënësit e shkollës “Faik Konica” për kursimin e energjisë elektrike

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

Prishtinë, 27 dhjetor - Nxënësit e shkollës “Faik Konica” në Prishtinë kanë pasur të martën rastin që ta prezantojnë punën që kanë bërë gjatë fushatës për kursimin e energjisë elektrike para ministres së Arsimit, Arbërie Nagavci, si dhe ministres së Ekonomisë, Artane Rizvanolli.

Gjatë vizitës në këtë shkollë ministret kanë përgëzuar nxënësit për këtë fushatë dhe kanë biseduar me ta për mënyrën se si mund të kursethet energjia elektrike dhe për ndikimin e tyre në këtë drejtim.

Ministria Nagavci theksoi se nxënësit e kësaj shkolle janë shumë aktivë në fushatat me rëndësi për komunitetin, ndërsa theksoi se kreativiteti i tyre në të ardhmen mund të sjellë rezultate edhe më të mëdha në inovacion. Megjithatë, ministrja tha se aktualisht është

shumë e rëndësishme që edhe nxënësit të ndikojnë në kursimin e energjisë elektrike, duke vetëdijësuar familjet dhe bashkëmoshatarët e tyre.

Pasi që përmendi pasojat e shumëfishta që ka konsumimi i pandërgjegjshëm i energjisë elektrike në buxhetin e shtetit, në buxhetin e familjes, por edhe në ndotjen e ambientit gjatë prodhimit të energjisë, ministria Nagavci bëri thirrje që energjia elektrike të shfrytëzohet në mënyrë efektive në shkollë, në familje e kudo tjetër.

Ndërkaq, ministria Rizvanolli foli për masat që ka ndërmarrë Qeveria e Kosovës në këtë drejtim dhe për rëndësinë e kursimit të energjisë. Ajo, po ashtu, theksoi edhe mënyrën se si po kursethet energjia elektrike në institucionet publike të Kosovës, ndërsa tha se praktika e kësaj shkolle për vetëdijësimin dhe kursimin e energjisë duhet të përcillet edhe nga shkollat e tjera.

## Sekuestrohen mbi 28 mijë euro të padeklaruara në Morinë, ndalohen dy shtetas nga Gjilani

PRISHTINË, 27 DHJETOR - Policia e Shtetit ka proceduar penalisht dy persona në doganën e Morinës pasi janë kapur me një sasi prej 28 500 euro të padeklaruara.

Gjatë kontrollit fizik policia i ka gjetur shtetasit D. R., 12 400 euro, ndërsa shtetasit D. Sh. 16

100 euro, të padeklaruara sipas përcaktimeve ligjore në fuqi.

Në cilësinë e provës materiale u sekuestruan 28 500 euro. “Në përfundim të veprimeve hetimore, specialistët e Seksionit për Hetimin e Krimeve Ekonomike e Financiare të Policisë së

Kukësit referuan materialet në Prokurori dhe nisi procedimi në gjendje të lirë për shtetasit D. R., 24 vjeç dhe D. Sh., 20 vjeç, banues në Gjilan, Kosovë, për veprën penale ‘Mosdeklarimi në kufi i të hollave dhe i sendeve me vlerë’”, ka njoftuar policia.





## Aliu: Asfaltimi i rrugëve në veri do ta shkurtojë lëvizjen e të gjithë banorëve

PRISHTINË, 27 DHJETOR - Ministri i Infrastrukturës, Liburn Aliu, ka njoftuar se ka përfunduar asfaltimi i rrugëve në veri të Kosovës. "Tani ka përfunduar edhe asfaltimi i rrugës në Maxherë, në veri të Republikës së Kosovës. Si rezultat i bashkëpunimit të ngushtë në mes të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit

Hapësinor dhe Infrastrukturës dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme kemi bërë asfaltimin e rrugëve në veri të vendit e që si rezultat këto rrugë do ta shkurtojnë lëvizjen e të gjithë banorëve, në veçanti në fshatra, që përmes këtyre ndërlidhjeve rrugore të rëndësishme do të kenë qasje më të shpejtë dhe

më të lehtë në komunën e Mitrovicës. Mbesim të përkushtuar në angazhimin tonë të përditshëm për një jetesë më të mirë për të gjithë qytetarët dhe jemi maksimalisht të angazhuar që t'i vazhdojmë asfaltimet e rrugëve në çdo cep të Kosovës", ka shkruar Aliu në "Facebook".



## Trefishohet hyrja e mjeteve piroteknike në Kosovë krahasuar me vitin 2021



PRISHTINË, 27 DHJETOR - Sivjet në Kosovë janë futur rreth 120 tonë mjete piroteknike për dallim nga viti i kaluar, kur ishin mbi 40 tonë. Qytetarët ankohen nga përdorimi i mjeteve piroteknike, ndërkohë që nga komuna janë caktuar afatet nga 25 dhjetori deri më 3 janar për përdorimin e tyre. Festat e fundvitit bëjnë që numri i përdoruesve të mjeteve piroteknike të shtohet. Shitësi i autorizuar që merret me shitjen e tyre ankohet se këtë vit ka rënë dukshëm

interesimi i qytetarëve për blerjen e tyre. "Shitja këtë vit për 50 % është e vogël se vitin e kaluar për shkak se ne kemi akcizë, është akciza shumë e lartë, i vetmi vend në rajon që e kemi akcizën", thotë Fadil Beqiri, shitës.

Qytetarët kërkojnë që të ndalohet përdorimi i mjeteve piroteknike me që përbën rrezik për ta.

Festat e fundvitit bëjnë që numri i përdoruesve të mjeteve piroteknike të shtohet. Shitësi i autorizuar që merret

me shitjen e tyre ankohet se këtë vit ka rënë dukshëm interesimi i qytetarëve për blerjen e tyre. "Shitja këtë vit për 50 % është e vogël se vitin e kaluar për shkak se ne kemi akcizë, është akciza shumë e lartë, i vetmi vend në rajon që e kemi akcizën", thotë Fadil Beqiri, shitës.

Qytetarët kërkojnë që të ndalohet përdorimi i mjeteve piroteknike me që përbën rrezik për ta. "Duhet gjithsesi me u ndalu këto, njëherë e përgjithmonë. Unë këtë kohë

duke kaluar dola prej shtëpisë, krisi e u shqetësova jashtëzakonisht e duhet me u ndalu, nëse ka mundësi", thotë Fehmi Kaleviqi, qytetar. "Nuk i përdori këto mjete piroteknike çka janë të rrezikshme, por ndonjë lloj si xixëllonjë çka janë festive të cilat janë më pak të rrezikshme", tha Albin Musa, qytetar.

Nga komuna e Prishtinës bëjnë me dije se ka nxjerrë një urdhëresë për ndalimin e përdorimit të produkteve piroteknike në vende publike,

për çka janë të obliguar t'i largojnë dhe t'i gjobitin. "Rregullorja komunale parasheh dënime në hapësira publike, nga 100 deri 500 euro, për të gjithë ata të cilët shesin në mënyrë ilegale", thotë Alban Ymeri nga Drejtoria e Inspeksionit.

Nga viti 2021, ku në Kosovë kanë hyrë mbi 40 tonë mjete piroteknike, Dogana e Kosovës thotë se këtë vit kanë hyrë rreth 120 tonë në vlerë mbi 200 mijë euro, raporton televizioni publik.

## Gërvalla në Emiratet e Bashkuara Arabe diskuton për investimet në Kosovë

PRISHTINË, 27 DHJETOR - Në kuadër të vizitës treditore bilaterale në Emiratet e Bashkuara Arabe, zëvendëskryeministrja dhe ministrja e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës, Donika Gërvalla, është takuar me kryesuesin e Odës së Ekonomisë dhe Tregtisë të Abu Dhabit, Abdullah M. Mazrui, me të cilin ka diskutuar për mundësi bashkëpunimi dhe investimi në industri të ndryshme në

Kosovë. Fillimisht ministrja e ka njoftuar delegacionin pritis rreth potencialit të jashtëzakonshëm që qytetarët e Republikës së Kosovës po e ofrojnë përmes punës së mrekullueshme në shumë sektorë.

Gërvalla ka theksuar nevojën për thellim të bashkëpunimit mes sektorit privat në bashkëpunim me qeveritë e të dy vendeve si ndërmjetësuere dhe fuqizuese të investimeve

të reja.

Më pas ministrja Gërvalla është informuar rreth pritjeve dhe detajeve të vjera në mënyrë që të hidhen hapa konkretë dhe të pavonuar përmes ekipeve të dedikuara për konkretizim të ideve.

Së fundmi ajo ka shprehur gatishmërinë e madhe që Republika dhe qytetarët e Kosovës kanë për të punuar së bashku për ngritjen e kapaciteteve dhe nivelit të ekonomisë e tregtisë.





# Në pyllin e magjepsur

Një autor anglez shumë i dashur edhe nga të rinjtë, imagjionon një aventurë Krishtlindjesh në pyjet finlandeze, perfekte për lexuesit e të gjitha moshave. Në të cilën një njeri gjen shpresë falë një magjie të çuditshme



Kisha ecur gjithë ditën në pyllin e dendur finlandez. Laura nuk kishte qenë kurrë në Finlandë, pasi pyjet nuk i interesonin. Ndoshta kjo shpjegonte gjithçka. Nuk kishte asgjë në Finlandë që të më bënte të mendoja për të. Por mbi të gjitha doja të largohesha për Krishtlindje; ishte një strategji shmangieje. Vitin e kaluar e kisha gjetur veten të bllokuar. I bllokuar nga Krishtlindjet, i rënduar me peshën e zisë, i paaftë për të dalë nga shtëpia. Gjithë ato dritare, ato pemë Krishtlindjeje dhe gjithë ato familje të lumtura.

Nuk po funksiononte. Edhe këtu, në natyrën e egër të Finlandës, nuk mund t'i shpëtoja mungesës së shpresës. Kuptova se njeriu mund të jetë i aftë për të mbajtur larg të ftohtin, por jo dhimbjen.

Dhe pastaj e pashë.

Plaku u ul në tokë, me shpinën pas një peme.

Pema ishte si mijëra të tjera që kisha parë tashmë. Ishte një pishë, jo bredh. Burri i mbante sytë mbyllur

dhe kishte veshur një pardesy ngjyrë kafe. Duhet të ketë qenë tek të shtatëdhjetat, ndoshta edhe më shumë. Fytyra e tij, sipër mjekrës, ishte e skuqur, me shenja. Për një moment mendova se kishte vdekur. Kish mbetur i palëvizur. Por më pas, vura re lëvizjen e lehtë të barkut të tij të rumbullakosur. Ishte si një diell që lindte, perëndonte dhe lindte përsëri.

"Ah," tha me një buzëqeshje të butë, sikur të ishte mikpritës në një festë ku nuk e dija se isha ftuar. "Ja tek qenke. Pothuaj në kohë." Anglishtja e tij ishte e përsosur, madje edhe përtej standardeve skandinave. "Pothuaj në kohë?", përsërita unë, i hutuar.

Ai qeshi me të madhe. Pastaj ai u ngrit në këmbë, duke u mbështetur me një dorë në tokë.

"A jeni mirë, zotëri?", e pyeta.

"Rrallëherë," tha ai. "Por unë nuk ndalem së shpresuari. Dhe gjithmonë duhet të shpresosh, apo jo? Në çdo moshë".

Nuk kisha përgjigje. Si mund të

shpresosh, kur të ka ikur gjëja më e mirë në gjithë jetën tëntë?

Një zog u ul pranë çizmes së majtë të plakut. Hodhi sytë përreth, duke lëvizur me tundje, si të gjithë zogjtë. Plaku zgjati dorën dhe mbylli sytë.

"Unë shpresoj që ky zog të ndalet në gishtin tim," tha ai.

Ishte i çmendur, mendova. Natyrisht. U përpoqa të gjeja një justifikim për t'u larguar. Problemi me pyjet është se të gjitha ligjet që rregullojnë arratisjen në jetën moderne (ke një takim dhe nuk mund të vonohesh, ke rezervuar një restorantet, do të të mbyllet dyqani) nuk vlejnin.

Por në atë moment, ndërsa belbëzova fjalën e parë të një fraze të improvizuar, zogu i vogël fluturoi dhe u ndal mbi gishtin tregues të burrit. Ai e pa krijesën me aq ëmbëlsi dhe habi, sa nuk i ngjante aspak një plakut.

Mund të ishte fare mirë edhe 7 vjeç. Sikur të më kish lexuar mendjen ai tha, "A të kujtohet kur ishe nëntë vjeç, Sam?"

Sam.

Nga e dinte emrin tim?

"E mban mend shtëpinë e zogjve që kishin prindërit e tu? A të kujtohet që shihje zogjtë që mbërrinin dhe nuk gjenin ushqim?"

A të kujtohet mëngjesi i Krishtlindjes kur dilje për të ushqyer zogjtë para se të hapnit dhuratat? Ti vishje pantoflat e babait dhe dilje në oborrin e mbuluar nga ngrica".

Ndjeva një shtrëngim në gjoks. "Kush drejqin je ti?"

Ai pa zogun. "Tani shko. Thuaj që jam gati".

"Shiko, më mirë të shkoj... duhet të kthehem. Në hotelin tim. Nëse errësohet, rrezikoj të mos e shoh rrugën".

Ai tundi kokën menjërisht. "Nëse errësohet, rrezikon të mos e shohësh rrugën. Kurrë nuk kam dëgjuar gjë më të vërtetë. Por rruga është ende aty".

"Më falni, nuk jam shumë i mirë në gjëgjëza."

"Më ke parë një herë, apo jo?"

Tashmë isha larguar prej tij dhe falë Zotit, sepse tashmë fytyra ime ishte ngrirë nga tronditja e vetëdijes së papritur. Ose të paktën, vetëdijësimi se ndoshta po çmendesha.

"Nuk kam parë asgjë. Kam pasur një imagjinatë të madhe kur isha fëmijë. Besoja çdo gjë. Edhe drerët fluturues. Në fakt, ishte një yll që po binte".

"Fëmija është ende aty, ta dish. Vetëm duhet të gjejë përsëri një shpresë. Pak besim".

Mbylla sytë nga trishtimi. U përpoqa të kontrolloja zërin tim. "Eshte e pamundur".

Ai shikoi qiellin. "Pamundësia është vetëm një mundësi që nuk e kupton ende".

Ndoqa vështrimin e tij dhe e pashë edhe unë. Atë që kishte parë si fëmijë. Dhe në atë moment ndjeva një ngrohtësi që nuk e kisha ndjerë për një kohë të gjatë. Një ngrohtësi që nuk kishte lidhje me shtatë shtresat e rrobave që kisha veshur. / Në shqip nga bota.al



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE**  
**'BUJOËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

## Muriqi kërkohet edhe nga dy klubet e Premierligës

**MALLORCA, 27 DHJETOR** - Sulmuesi Vedat Muriqi mund të largohet nga Mallorca në afatin kalimtar të janarit. Sulmuesi "dardan" e kaloi një vit të jashtëzakonshëm në

klubin ishullor duke bërë që klubet e njohura evropiane të interesohen për shërbimet e tij. Në ditët e fundit u spekuloi për interesimin e dy skuadrave madrilene, Real dhe

Atletico, për shërbimet e 28-vjeçarit. Ndërsa tash thuhet se përfaqësuesin e Kosovës e duan edhe në ligën më të fortë të futbollit në botë - në Premierligë.

Sipas medieve spanjolle, dy klubet e fundit që kanë shprehur interesim për ish-futbollistin e Rizesporit, Fenerbahçes e Lazios, janë Aston Villa dhe Evertoni.



# Përzgjidhen 10 'Shpresat Olimprike 2023' që mbështeten nga MKRS-ja

**PRISHTINË, 27 DHJETOR** - Bordi Ekzekutiv i Komitetit Olimpik të Kosovës (KOK) ka miratuar raportin e komisionit të sportit për përzgjedhjen e 10 shpresave olimprike 2023. Bursistët do të mbështeten me nga 150 euro në muaj nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS), sipas rregullores për ndarjen e bursave për shpresat olimprike dhe paralimprike.

Përzgjedhja e bursistëve është bërë bazuar në rezultatet e arritura në vitin 2022. Përveç skitares Kiana Kryeziu, e cila mori pjesë me normë olimprike në Lojërat Olimprike Dimërore Pekini 2022, nëntë bursistët e tjerë të përzgjedhur janë, po ashtu, me medalje të fituara në Kampionate Evropiane ose Ballkanike dhe Kupa Evropiane. Nga sporti i xhudos janë Dardan Cena, medalist i bronzit evropian U-18 e Laurina Gashi, dy herë

medaliste (e artë dhe argjendte) në Kupën Evropiane për kadete. Nga boksi janë medalistët e bronzit evropian për juniorë, Taulant Jakupi e Donat Sylja. Atletikën e përfaqëson medalisti i artë ballkanik U-18, Enis Bytyqi. Rezultatet e mundjes në grupmoshat e reja gjatë këtij viti kanë bërë që dy vajzat, Elsa Nikoci dhe Lonisa Reka, të jenë në top 10-she.

Elsa me dy fitore doli e pesta në Evropianin U-15 si dhe nënkampione e Ballkanit U-15, ndërsa Lonisa, nënkampione e Ballkanit me U-17. Në 10-she janë përfshirë edhe dy taekwondistët, medalistë ballkanikë, Jon Gashi dhe Elion Agushi. KOK-ja në janar do ta shpallë sërish aplikimin për federatat sportive olimprike për bursistët shpresa olimprike 2023, të cilët do të mbështeten nga KOK-u, e ku numri i bursistëve pritet të jetë mbi 25.

**LISTA E 10 BURSISTËVE "SHPRESA OLIMPRIKE 2023"**

- Dardan Cena (xhudo)
- Laurina Gashi (xhudo)
- Enis Bytyqi (atletikë)
- Taulant Jakupi (boksi)
- Donat Sylja (boksi)
- Kiana Kryeziu (skitari)
- Elion Agushi (taekwondo)
- Jon Gashi (taekwondo)
- Elsa Nikoci (mundje)
- Lonisa Reka (mundje)


## Licencohen Federata e Basketbollit, e Volejbollit dhe e Atletikës

**PRISHTINË, 27 DHJETOR** - Në kuadër të licencimit të federatave sportive sipas udhëzimit të ri administrativ për licencimin e federatave, sot ministri i Sportit, Hajrulla Çeku, së bashku me zëvendësministren Daulina Osmani, pritën në takim udhëheqësit e këtyre tri federatave. Kësaj radhe, pas rekomandimit pozitiv të komisionit për licencim në kuadër të Ministrisë së Sportit, ministri Çeku i ka nënshkruar dhe i ka dorëzuar zyrtarisht licencën për ushtrimin e veprimtarisë kryetarit të Federatës së Basketbollit, Arben Fetahu, kryetarit të Federatës së Volejbollit, Bahri Gjinovci, dhe kryetarit të Federatës së Atletikës, Halil Sylejmani. MKRS-ja i ka përgëzuar dhe u ka uruar suksese tri federatave në veprimtarinë e tyre sportive.



## Rrahmani rikthehet në stërvitje

Napoli e ka marrë një lajm të mirë të martën. Amir Rrahmani më në fund i është bashkuar ekipit në stërvitje, njoftojnë mediet italiane. Qendëmbrojtësi kosovar ka munguar që një kohë të gjatë, ndërsa ishte lënduar në ndeshje me Cremonesen. Sidoqoftë, Rrahmani e ka lënë prapa krahëve tërheqjen muskulore dhe tash është gati për sfidat e reja. Trajneri Luciano Spalletti pret që ta ketë në dispozicion njërin prej liderëve të tij për ndeshjen e 4 janarit ndaj Interit në kampionat. Rrahmani është pjesë e rëndësishme e napolitanëve këtë sezon, të cilët prijnë në Serinë A dhe po u ecin punët mjaft mirë edhe në Ligën e Kampionëve.



## Liverpooli transferon Gakpon

Sulmuesi holandez Cody Gakpo është futbollisti më i ri i Liverpoolit. Ka qenë vetë faqja zyrtare e klubit e cila

me anë të një postimi publikoi lajmin për arritjen e marrëveshjes. Në mediet britanike është mësuar se

Liverpooli ka paguar 53 milionë euro, përfshirë bonuset për kartonin e 23-vjeçarit, aq sa kërkonte dhe

PSV Eindhoven. Cody Gakpo ishte një nga elementet kryesore të Holandës në Botërorin e

Katarit, teksa u bë i pari holandez që shënoi në secilën ndeshje të fazës së grupeve.



## Benzema ishte i gatshëm të luante në Botëror, Deschamps i la jashtë

PARIS, 27 DHJETOR - "Benzema mund të ishte në dispozicion që nga 1/16", ka thënë Karim Djaziri, agjenti i sulmuesit francez të Real Madridit, duke ndezur edhe një herë polemikat për përplasjen e Didier Deschamps me

bomberin francez. Djaziri ka postuar në profilin e tij të rrjeteve sociale imazhin e rezonancës e cila zbulon gjendjen e dëmtimit të muskujve të Benzemas. "Unë e postova, por në fillim u konsultova me tre ortopedë, të

gjithë më siguruan se Karim Benzema mund të ishte i disponueshëm që nga raundi i 1/16". Kjo konfirmon problemet e marrëdhënieve personale mes sulmuesit të Francës me trajnerin e kombëtares së "gjelave". Dhe

jo çuditërisht, pas humbjes në finalen e Kupës së Botës, Benzema shpalli lamtumirën e tij me kombëtaren franceze, madje përpara këtij vendimi ai refuzoi ftesën e Macronit për të qenë i pranishëm në stadium për ta parë finalen.



## Sokoli pritët ta marrë drejtimin e Kukësit

KUKËS, 27 DHJETOR - Trajneri i futbollit, Bylbyl Sokoli, pritët ta marrë drejtimin e skuadrës shqiptare, Kukësit. Sipas raportimeve nga "Panorama", Sokoli është një opsion konkret për Kukësin dhe palët shumë shpejt mund të arrijnë në një marrëveshje. Gjithsesi, ndryshe nga sa ka ndodhur zakonisht, kur ishin kuksianët ata që i vendosnin kushte trajnerit, tani është ky i fundit që ka vënë kushtet e tij. Bëhet fjalë për stërvitjen dhe grumbullimin e skuadrës në Kukës, gjë që për momentin duket e vështirë të plotësohet nga klubi, sepse bazën e ka në kryeqytet dhe në Kukës shkon vetëm për ndeshje. Emri i 64-vjeçarit është lidhur edhe më herët me ekipin e Kukësit, por tani duket se gjërat janë pjekur dhe është kandidati më i mundshëm për të marrë në dorë skuadrën në këtë krizë që e ka kapur.



Sokoli është trajnuar në disa prej ekipeve kryesore në kampionatin kosovar, së fundmi ka qenë pjesë e skuadrës së Gjilanit. Megjithatë, aventurat e tij nuk kanë zgjatur shumë, duke ndërruar shpesh disa ekipe. Kushdo që do të marrë përsipër ta drejtojë Kukësin për pjesën e mbetur të sezonit nuk do

ta ketë një sipërmarrje të lehtë. Së pari, duhet të largohet sa më parë nga zona e ftohtë, sepse rreziku është real. Së dyti, duhet të sigurojë me çdo kusht Evropën, në të kundërt bëhet sezoni i tretë radhazi që nuk merr pjesë dhe dëmet financiare të klubit janë shumë të mëdha.

## Fitojnë Brooklyni, Miami dhe Clippersat

CLEVELAND, 27 DHJETOR - Nuk ndalet rrugëtimi i ekipit të Brooklynit, që është skuadra më e mirë momentalisht në NBA. Netsi korri fitoren e 9 radhazi, duke mundur 125-117 Clevelandin dhe u ngjiti në vendin e tretë në Lindje dhe Duranti realizuan nga 32 pikë secili, duke bërë dallimin në fushë. Pas kohës shtesë fiton ekipi i Clippersave, që mundi me rezultat 142-131 Detroitin jashtë fushës. Ndeshje spektakolare, ku për miqtë u dallua Paul George me 32 pikë e 11 asistime. Fiton edhe Miami, që mundi me rezultat 113-



110 Minnesotan, sfidë ku diferencën e bëri stoli i ekipit nga Florida, nga ku erdhën 45 pikë. New Orleans ngjitet në vendin e dytë në Perëndim pas fitores me rezultat 113-93 ndaj Indianas, duke rritur pretendimet. Për vendasit u

dallua Marshall me 22 pikë. Fitore të lehtë korri Houstoni, që mundi me shifrat 133-118 Chicagon (Porter Jr.33 pikë), ndërsa Portlandi, falë 32 pikëve e 10 reboundeve të Grantit, mundi 124-113 Charlotten.

### REZULTATET

Cleveland - Brooklyn	117-125
Detroit - Clippers	131-142
Miami - Minnesota	113-110
Chicago - Houston	118-133
New Orleans - Indiana	113-93
San Antonio - Utah Jazz	126-122
Portland - Charlotte	124-113

## De Bruyne: Haalandi mund të shënojë deri në 800 gola

Erling Haaland ka shënuar tashmë 180 gola në karrierën e tij profesionale, edhe pse është vetëm 22-vjeçar. Shoku i tij i skuadrës në Manchester City, Kevin de Bruyne, beson se qendërsulmuesi do të vazhdojë

të shënojë për vitet në vijim dhe të arrijë ato rekorde që vetëm Lionel Messi ose Cristiano Ronaldo i kanë arritur kohët e fundit. "Erling është kaq i fiksuar pas golave dhe ai tashmë ka rreth 200 gola, kështu që

ndoshta mund të shkojë në 600, 700 ose 800 nëse qëndron në formë dhe bën gjërat që bën", ka thënë De Bruyne. "Unë nuk i krahasoj sulmuesit sepse nuk është mënyra se si e shikoj futbollin, por Erling është një

sulmues i nivelit të lartë", ka shtuar mesfushori belg. De Bruyne vazhdoi duke lavdëruar Haalandin për qëndrimin e tij dhe qasjen e tij ndaj lojës. "Unë nuk e shoh Erlingun si të ndryshëm nga

shumë njerëz. Ai është ende një djalë i ri që shijon jetën e tij dhe e merr shumë seriozisht futbollin e tij. Atij i pëlqen të shënojë gola, kështu që mendoj se kjo është gjëja më unike që ka", shtoi De Bruyne.

### SHKURT

#### Hamilton: Do ta rinovoj kontratën me Mercedesin

Piloti britanik Lewis Hamilton ka ende edhe një vit kontratë me makinën e Mercedesit e cila skadon në dhjetor të 2023-shit. Pas problemeve që hasi këtë sezon, u përfol se shtatë herë kampioni i botës do të nisë një aventurë të re, por duket se ai i ka idetë e qarta. "Besoj se do ta rinovoj kontratën me Mercedesin. Deri më tani nuk kam biseduar për të ardhmen, por nuk besoj se do të duhet shumë për t'i hedhur firmat. Me shumë gjasë do të qëndroj këtu", u shpreh Lewis Hamiltoni. "Unë kam besim te Mercedesi dhe ëndrra e çdo piloti është që të tërhiqet nga sporti si kampion bote. Unë besoj te kjo gjë dhe besoj se Mercedesi do të ringrihet. Kemi punuar shumë", ka shtuar piloti britanik, që këtë sezon nuk arriti asnjë fitore në Formula 1.

#### Ibra: Milano është shtëpia ime e dytë, qëndroj këtu edhe pasi ta lë futbollin

Në një intervistë për "Tonight in Milan", Zlatan Ibrahimović ka folur "pa doreza", duke treguar lidhjen e veçantë që ka me qytetin. Sulmuesi foli edhe për të ardhmen e tij. "San Siro është i veçantë ashtu si ky qytet. Për 8-9 vjet ky qytet e stadium ishin pjesë e karrierës sime. Jam me fat pasi këto vite ishin mjaftueshëm për të fituar trofe të rëndësishëm, për të luajtur me kampionë të mëdhenj dhe për të punuar me trajnerë të mëdhenj", ka thënë futbollisti. "Milano? Është si një shtëpi e dytë për mua. Kam kaluar shumë vite këtu, kam takuar njerëz që më bëjnë të ndihem si në shtëpinë time, ndihem shumë komod, më pëlqen, jetoj dhe ndihem i gjallë. Nuk është sekret që mund të qëndroj këtu edhe pas përfundimit të karrierës", ka deklaruar Ibra.

#### Kloppi: Messi është lojtari më i mirë që kam parë ndonjëherë

"Lionel Messi ka qenë më i miri nga të gjithë lojtarët që kam takuar", ka thënë Vicente Del Bosque pak ditë më parë për kapitenin e kombëtares së Argentinës. Në të njëjtën linjë ai që ngriti zërin për ta lavdëruar yllin e Rosarios ishte trajneri i Liverpoolit, Jurgen Kloop, i cili theksoi se për të ishte një kënaqësi ta shihte në Botërorin e Katarit 2022. "Ai është lojtari më i mirë që kam parë ndonjëherë në jetën time. Mënyra se si ai luan futboll në moshën e tij më habit. Performanca e tij mund të na japë një ide se sa kohë mund të luajnë futbollistët në nivelin më të lartë. Ishte një kënaqësi për mua që ta shihja atë në Kupën e Botës. Ajo finale ishte një mrekulli. Pas 80 minutave lojë unë kam parë finalen më të bukur ndonjëherë, jam shumë i lumtur. Është diçka e veçantë, ata e meritonin", është shprehur trajneri gjerman.











## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

